

NJË VËSHTRIM MBI TREGUESIT E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË SHQIPËRISË

Janar – Dhjetor 2019

SEKRETARIATI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE


Mars 2020

Shënim: Materiali është një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë na Shqipëri dhe rajon të disponueshme deri në datën e publikimit të këtij materiali dhe nuk përfaqëson opinionet apo pikëpamjet e Sekretariatit dhe Këshillit të Investimeve.

Të dhënat e përdorura në prezantim janë gjeneruar nga bazat e të dhënave në faqet zyrtare të Institutit të Statistikave (INSTAT), Bankës së Shqipërisë, Bankës Botërore, Fondit Monetar.

Ecuria e Rritjes Ekonomike

Figura 1. Rritja ekonomike, Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor




Burimi: BB, World Development Indicators

Rimëkëmbja ekonomike u konfirmua në vitin 2015, dhe ka vijuar në vitet në vijim deri në vitin 2018 ku ekonomia u rrit me 4,1%.

INSTAT jep një vlerësim paraprak të PBB-së për vitin 2019, i cili mbështetet në vlerësimet tremujore - rritje prej 2,21% krahasuar me vitin 2018

E ardhura për frymë

Figura 2. Produkti I Brendshëm Bruto per frymë (USD/fryme)




Burimi: World Development Indicators

Për vitin 2018, e ardhura për frymë e Shqipërisë vlerësohet 5,269 USD në vlerë korrente, me një rritje prej 16% krahasuar me një vit më parë

GDP/capita in current USD	2018
XKX	4,302
ALB	5,269
BiH	6,066
MKD	6,084
WB	6,302
SRB	7,247
MNE	8,844
Euro Area	39,928

Rritja ekonomike sipas sektorëve

Figura 3. Rritja vjetore, sipas tremujoreve ne %



Burimi: INSTAT


Bazuar në vlerësimet paraprake të INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) në tremujorin e katërt të vitit 2019 ra me 0,15% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar; ndërsa krahasuar me tremujorin paraardhës ra me 0.22%

Kontributin kryesor në këtë rënie vjetore e dhanë Ndërtimi (-1,68 p.p) si edhe Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative (0,45p.p). Pozitivisht ndikuan degët Industri, Energji dhe Ujë (1,06p.p), Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor (+0.43 p.p).

INSTAT jep një vlerësim paraprak të PBB-së për vitin 2019, i cili mbështetur në vlerësimet tremujore, pati rritje prej 2,21% krahasuar me vitin 2018

Qarkullimi i mallrave në Tregtinë e Jashtme

Figura 4. Tregtia e jashtme, miliardë lekë




Burimi: INSTAT

Gjatë vitit 2019, eksportet e mallrave arritën 299 miliardë lekë, 3.5% më pak se një vit më parë. Importet arritën në 649 miliardë lekë me një rritje 1.2% krahasuar me vitin 2018.

Deficiti tregtar u rrit me 5.7% gjatë vitit 2019, duke arritur në 350 miliardë lekë.

Eksportet e Mallrave

Figura 5. Eksporte sipas produkteve, pesha në %




Burimi: INSTAT

40% e totalit të eksporteve shqiptare janë "Tekstile dhe këpucë", 17% "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike", 15% "Materiale ndërtimi dhe metale", ndjekur nga "Ushqime, pije dhe duhan" me 12%.

Importet e Mallrave

Figura 6. Importet sipas produkteve, pesha në %




Burimi: INSTAT


21% e mallrave të importuara nga shqiptarët përfshihen në grupin "Makinëri, pajisje dhe pjesë këmbimi"; 17% janë "Ushqime, pije dhe duhan", të ndjekur nga "Produkte kimike dhe plastike" me 14%.

EKSPORTET NË SHËRBIME - KONTEKSTI RAJONAL

Figura 7. Eksportet në shërbime, Ballkani Perëndimor në million USD



2018




Shqipëria renditet e dyta në rajon përsa i përket eksportit të shërbimeve, ku dominojnë Udhëtimet me 61.2% të totalit të eksporteve.

Burimi: World Development Indicators

Indeksi i Çmimit të Konsumit

Figura 8. Indeksi I Cmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor %




Burimi: INSTAT

Gjatë vitit 2019, Inflacioni mesatar me bazë vjetore ishte 1.4%, më i ulët se një vit më parë, ku inflacioni rregjistroi 2%.

Bazuar edhe në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3%.

Forca e Punës

Figura 9. Norma e papunësisë




Burimi: INSTAT

Gjatë 2019 Shkalla e papunësisë ka vijuar ritmin rënës të katër viteve të fundit, duke shënuar një ulje 0.8 p.p krahasuar me një vit më parë.

Në 2019, qarqet me normë papunësie më të ulët për popullsinë 15+ vjeç janë: Elbasani (5,4%), Berat (7,1%) dhe Kuksi (7,3%) ndërsa qarku me shkallë papunësimi më të lartë është qarku Lezhë (17,7%), Vlorë (15,2%) dhe Tiranë (15%)

Paga Mesatare sipas Sektorëve (në Lekë)

Figura 10 Paga mesatare sipas sektoreve të ekonomisë




Paga mesatare mujore - është paga bruto që merr një i punësuar për punën që ka kryer
Burimi: INSTAT

Pagat më të larta edhe për vitin 2019 u regjistruan në sektorin e “Aktiviteteve financiare dhe sigurimit”, pasuar nga “Informacioni dhe Komunikimi”.

Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin “Tregti me shumicë dhe pakicë”.

Paga Mesatare dhe Paga minimale

Figura 11 Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë dhe paga minimale e miratuar



Burimi INSTAT

Paga mesatare në vitin 2019 është raportuar në 53,458 lekë dhe është rritur me 5,7% në terma vjetorë. Paga mesatre mujore për një të punësuar në sektrin privat ishte 48.767 lekë me një rritje 5% krahasuar me një vit më parë; Ndërkohë paga mesater mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte 63.826 lekë, me një rënie të lehtë krahasuar me një vit më parë.

Paga minimale gjatë vitit 2019 ishte 26.000 lekë.

Kosto e Punës për Vendet e Ballkanit Perëndimor

Figura 12. Pagat mesatare per nje te punesuar ne Ballkanin Perendimor (EURO)




Burimi: Zyrat statistikore te vendeve

Paga mesatare bruto më e lartë në rajon është rregjistruar në Malin e Zi, e ndjekur nga Bosnjë dhe Hercegovina, ndërkohë Shqipëria vazhdon të ketë pagën mesatare më të ulët në rajon.

(Shënim: Instituti i Statistikave të Kosovës ende nuk ka publikuar të dhënat për vitin 2019)

Investimet në Shqipëri


Figura 13. Investimet publike, private dhe te huaja ne Shqipëri (% ndaj PBB)



Pjesa më e madhe e investimeve në ekonomi vjen nga sektori i brendshëm. Gjatë vitit 2018, investimet private ishin sa 18.9% e Produktit të Brendshëm Bruto, ndërsa ato publike ishin në nivelin e 4.8% të PBB.

Investimet sipas Sektorëve

Figura 14. investimet për prodhuesit e të mirave e shërbimeve për treg




Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, gjatë 2018, investimet private u rritën me 2.8%, dhe 38.6% e Investimeve vijnë nga prodhuesit e shërbimeve.

Shumica e investimeve gjatë vitit 2018, kanë qenë investime në Makineri dhe Pajisje, 33% e totalit, duke ruajtur të njëjtin trend të vitit të mëparshëm edhe pse me një rënie prej 7%.


Gjatë vitit 2018, janë rritur investimet në Ndërtesa, Ndërtim dhe Instalime, Mjete Transporti, dhe Tokë.

Investimet e Huaja Direkte

Figura 15. Investimet e Huaja Direkte, milion EURO



Gjatë 2019, fluksi hyrës i IHD u rrit me 6% krahasuar me një vit më parë.




Edhe pse flukset hyrëse të IHD kanë qenë mjaft të ndryshueshme sipas cikleve të biznesit, që nga 2015 stoku i IHD në Shqipëri ka ruajtur një trend rritës;

Stoku i IHD u rrit me 12% krahasuar me një vit më parë dhe 3% krahasuar me një tremujor më parë.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Figure 16 Stoku IHD sipas vendit te origjines, milion EURO




Burimi: Banka e Shqipërisë

Zvicra udhëheq stokun e IHD-ve në terma vëllimi, 18% e totalit, e ndjekur nga Holanda me 14% të totalit;

Dinamika pozitive të IHD-ve vijnë nga Bullgaria, ndërkohë Greqia ka ngadalësuar flukset hyrëse të IHD duke filluar nga tremujori I i 2019.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Figura 17. Fluksi IHD sipas vendit te origjines, million EURO




Burimi: Banka e Shqipërisë

Bazuar në të dhënat më të fundit të BSH, janë rritur flukset hyrëse të IHD nga Italia, të ndjekur nga Holanda dhe Bullgaria.

Ndërkohë, flukset hyrëse nga Zvicra edhe pse pozitive janë në rënie, e ndjekur edhe nga Austria, dhe Turqia; nga ana tjetër, Greqia ka treguar shënja përmirësimi gjatë fund vitit 2019.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Figure 18. Fluksi IHD sipas aktivitetit ekonomik, million EURO




Burimi: Banka e Shqiperise

Sektorët më tërheqës për IHD-të janë Energjia Elektrike, Minierat dhe Industritë Nxjerrëse.

Një ngadalësim në stokun e TIK dhe Sektorit të Transportit / Akomodimit vërehet duke filluar nga çereku i dytë i vitit 2017.

Fluksi i IHD në Ballkanin Perëndimor

Figure 19 Fluksi IHD në Ballkanin Perëndimor, % PBB



Burimi: World Development Indicators

Shqipëria renditet e dyta në rajon për IHD me 8% të PBB.

Mal i Zi zë vendin e parë në rajon për flukset hyrëse të IHD, të cilat janë sa 9% e PBB.


Ndërsa vendin e fundit në rajon e zë Bosnia & Hercegovina së bashku me Kosovën, me respektivisht 2% dhe 3% të PBB.

Fluksi i IHD në Ballkanin Perëndimor

Flukset hyrëse të IHD në Serbi arritën në 4 miliardë USD për vitin 2018, ndërsa në Shqipëri ato kapën shifrën e 1.2 miliardë USD.

Vendi me më pak flukse hyrëse të IHD në rajon është, Kosova me 319 milionë USD, por me një trend gjithmonë në rritje.

Figura 20. Fluksi IHD ne Ballkanin Perëndimor, million USD



Burimi: World Development Indicators

Stoku dhe Profili i Ndërmarrjeve

Figura 21. Stoku dhe Profili i Ndërmarrjeve

Sipas numrit të punësuarve							
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	106,837	111,083	112,537	152,288	160,679	162,452	162,835
1-4	95,520	99,782	101,025	136,470	145,456	146,304	145,549
5-9	5,636	5,235	5,387	8,172	7,631	8,023	8,518
10-49	4,439	4,660	4,647	5,994	5,902	6,297	6,801
50+	1,242	1,406	1,478	1,652	1,690	1,828	1,967
Prodhuesit e të mirave	16,413	16,842	16,989	37,950	48,585	53,250	56,916
1-4	12,592	13,071	13,273	33,255	44,179	48,819	52,269
5-9	1,718	1,565	1,603	2,080	1,865	1,842	1,858
10-49	1,650	1,681	1,562	1,971	1,877	1,851	1,987
50+	453	525	551	644	664	738	802
Prodhuesit e shërbimeve	90,424	94,241	95,548	114,338	112,094	109,202	105,919
1-4	82,928	86,711	87,752	103,215	101,277	97,485	93,280
5-9	3,918	3,670	3,784	6,092	5,766	6,181	6,660
10-49	2,789	2,979	3,085	4,023	4,025	4,446	4,814
50+	789	881	927	1,008	1,026	1,090	1,165


Burimi: Rregjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, INSTAT

Struktura e ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare dominohet nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të cilat përfaqësojnë 99% të ndërmarrjeve.

Në vitin 2018, 35% e ndërmarrjeve të regjistruara vepronin si prodhues të mallrave, 65% janë raportuar si operatorë në sektorin e shërbimeve.


Ndërmarrjet Aktive sipas Aktivitetit Ekonomik

Figura 22 . Ndërmarrjet aktive, fundviti 2018 dhe ndërmarrjet e reja gjatë 2018



Të ardhurat buxhetore

Figura 23. Te ardhurat buxhetore, % PBB




Burimi: World Economic Outlook, FMN October 2019

Mal i Zi, Bosnia dhe Hercegovina dhe Serbia kanë të ardhura buxhetore mbi mesataren e rajonit, prej 34.7% të PBB.

Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut mbeten poshtë mesatares së rajonit, me respektivisht, 26.2%, 27.1% dhe 30% të PBB gjatë vitit 2019.

Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore


Figura 24. Te ardhura dhe shpenzime buxhetore, % PBB



Burimi: World Development Indicators

Dinamikat e Borxhit Publik

Figura 25. Dinamikat e borxhit publik, % PBB



Burimi: World Economic Outlook, FMN Tetor 2019

Borxhi publik mbetet i lartë në rajonin e BP. Maqedonia e Veriut ka normën më të lartë të borxhit në % të PBB, 81.1% në 2019, e ndjekur nga Shqipëria me 66.7% të PBB në 2019.

Kosova vazhdon të ketë normën më të ulët të borxhit publik me rreth 18% të PBB në 2019, por me një trend rritës.

Taksat Kryesore për 2019

- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - 20%
- Tatimi mbi Fitimin, Xhiro Vjetore:
 - 0-5 milion ALL ($\approx$ 36,500 EUR) – 0%
 - Mbi 5 milion – 8 milion ALL ($\approx$ 58,400 EUR) – 5%
 - Mbi 8 milion ALL – 15%
- Tatimi mbi Dividentin – 8%

Renditja e Shqipërisë në Raportet dhe Indekset Ndërkombëtare

Figure 26 Renditja e Shqipërisë në raportet ndërkombëtare

Indeksi I Perceptimit të Korrupsionit, Transparency International

Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018	Vlera 2017	Renditja 2017
35	106/180	36	99/180	38	91/180

Indeksi I Lirisë Ekonomike, Heritage.org

Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2017	Renditja 2018
66.9	57/180	66.5	52/180	64.5	65/180

Të Bërit Biznes, Banka Botërore


Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2017	Renditja 2018
67.7	82/190	69.5	63/190	68.7	65/190

Indeksi I Konkurrueshmërisë Botërore, Forumi Ekonomik Botëror

Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018	Vlera 2017	Renditja 2017
57.6	81/141	58	76/140		75/137

Treguesi i Lehtësisë së të Bërit Biznes

Figura 27. Renditja e vendeve te Ballkanit Perendimor, Lehtësia e të bërit biznes




Burimi: Banka Botërore, Indikatorët e Doing Business

Maqedonia e Veriut ka renditjen më të mirë në rajon edhe pse pozitat e saj janë përkeqësuar gjatë vlerësimit të 2020; edhe Shqipëria ka përkeqësuar pozitat e saj gjatë vlerësimit 2020, krahasuar me një vit më parë.

Indikatorët e Doing Business

Figura 28. Renditja e Shqipërisë sipas Indikatorëve, Doing Business



Burimi: WB, Doing Business

Shqipëria renditet më poshtë në fushën e trajtimit të lejeve të ndërtimit, energjisë, procedurave fiskale dhe regjistrimit të pronës.

Tregtia përtej Kufijve – DB 2020

Figura 29. Tregtia përtej kufijve - Eksporte, koha dhe kosto

	Shqiperia	Europa dhe Azia qendrore	Renditja në 190 vende
Koha - Kontrolli ne kufi (ore)	9	22.1	
Kosto - Kontrolli ne kufi (USD)	55	157.5	
Koha - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (orë)	6	24.3	
Kosto - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (USD)	10	97.9	
Renditja			24

Burimi: Doing Business, BB

Tregtia përtej Kufijve – DB 2020


Figura 30. Tregtia përtej kufijve - Importe

	Shqiperia	Europa dhe Azia qendrore	Renditja në 190 vende
Koha - Kontrolli ne kufi (ore)	10	21.1	
Kosto - Kontrolli ne kufi (USD)	77	162.3	
Koha - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (	8	24.7	
Kosto - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave	10	93.9	
Renditja			24

Burimi: Doing Business, BB

Indikatorët e Konkurrueshmërisë

Figura 31. Indikatorët e Konkurrueshmërisë, Renditja e Shqipërisë



Gjatë 2019, indikatorët Infrastruktura, dhe Sistemi Financiar janë përmirësuar; ndërsa indikatorët Institucionet, Sofistikimet e biznesit dhe Inovacioni janë përkeqësuar

Liria Ekonomike

Figure 32. Trendi I Lirisë Ekonomike, Shqipëria



Burimi: www.heritage.org

Shqipëria renditet e 52a në rang botëror, duke u përmirësuar me 2 pikë nga viti i kaluar;


Në rang rajonal, Shqipëria renditet e 27a nga 44 vende europiane.

Vendi qëndron poshtë mesatares europiane (68.8) por është mbi mesataren botërore (60.8).


Treguesit e Lirisë Ekonomike

Figura 33. Treguesit e Lirise Ekonomike


Sundimi I ligjit




madhesia e qeverise



efektiviteti rregulator



liria e te berit tregti



EBRD Knowledge Economy Index

Figura 34. EBRD Knowledge Economy Index 2018

	<i>Renditja (46 ekonomi)</i>	<i>Vlerësimi I përgjithshëm</i>	<i>Institucione për inovacion</i>	<i>Aftësi për inovacion</i>	<i>Sisteme innovative</i>	<i>Infrastruktura TIK</i>
SRB	13	5.13	5.76	5.46	3.26	6.02
MNE	14	5.04	6.20	5.16	2.88	5.92
MKD	22	4.50	5.74	3.83	3.27	5.18
ALB	25	4.36	5.64	4.79	2.36	4.67
BIH	29	4.10	5.04	4.13	2.88	4.35
XKX	35	3.22	4.81	2.75	3.12	2.20

Burimi: Banka Europiane për Rindertim e Zhvillim